



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË
616-22-14042-2-2-1/C1096

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;
dhe

Fatmir Godeni B.I., Rruga e Jonit, PRIZREN, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjeter, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e paisjeve të fitnesit dhe këndit të lodrave në kryeqytet me numër identifikues: 616-22-14042-2-2-1

Neni 1 **Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e paisjeve të fitnesit dhe këndit të lodrave në kryeqytet

Nr.	Grupi
1	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e paisjeve të fitnesit dhe këndit të lodrave në kryeqytet

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjeter Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasisë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 15.03.2023 dhe përfundon në datën 15.03.2024

Neni 2 **Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **12 muaj**

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Komuna e Prishtinës

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale e kontratës është **73.000,00 €**, ndërsa vlera totale e poentuar e kontratës është **11,590.30 Euro**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjeter të dosjes së tenderit]*.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvçe nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rr Ethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet ¹ në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

¹ Gjuha do të jetë gjaja e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

AUTORITETI KONTRAKTUES		OPERATORI EKONOMIK	
Emri:	Visar Shehu	Emri:	FATMIRE GOREV
Pozita:	U.D. i Departamentit të Prokurimit	Pozita:	Federacija Kosovare Federacione Sporting
Nënskrimi:		Nënskrimi:	
Data:	15.03.2023	Data:	15.03.2023
Vula:		Vula:	RIZREN



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Cmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përshtatje apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënes së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjeter financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktivitetave.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyet:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvçese kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjate.

Neni 8 **Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënë të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetat, shtrëngatat, vëtëtimi, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruejë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai,

duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmisht e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të batojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitetë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “*Menaxherin e Projektit*”, i cekur në KV, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënen e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofriuesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofriuesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofriuesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofriuesi i sherbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizonj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të sakta sohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofriuesit të Sherbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofriuesi i Shërbimit

15.1 Ofriuesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga tregjet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofriuesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofriuesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofriuesi

i Shërbimeve. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat gendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KV. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KV.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofroesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekë për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofroesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofroesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofroesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofroesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofroesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim të ZKA
Siguria ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së Përgjithshme të kontratës në vlerë prej: 7.300 €, në validitet prej 13 muajsh
Kualiteti Kontrollit	17.1	Periudha e përgjegjësise së Defekteve është 2 vite
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Zgjidhja miqësore ndërmjet palëve në objektin e AK-së</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë.

"Ndertimi dhe mirmbajtja e pajisjeve të Fitnesit dhe këndeve te Lodrave" në Komunën e Prishtinës

Kushte të përgjithshme:

Përshkrimi i punëve. Në përpueuthshmëri të plotë me standartet IEC dhe ISO.


Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsyet e ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtes. Pra në këte mënyrë



Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngajshme të prodhuesve të ndryshëm në përputhje me standartet EC dhe ISO.


Të gjitha pozicionet përfshijnë, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vuarjen në vepër të materialeve për secilin pozicion

Nr.	Përshkrimi i Punëve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma:
1	Punët, kubzat, pjerrinat dhe dyshemeja prej gome			1: Totali i (20 % e pikëve për vlerësim)	
1.1	Furnizimi, transporti dhe riparimi i dyshemeve, ku përfshihet mbushja me rërë të imët tek hapsirat e lodrave.	m ³	1.00	25.00	25.00 €
1.2	Furnizimi, transporti dhe riparimi i dyshemesë, ku përfshihen anësoret e dëmtuara të betonit largimi i tyre, furnizimi dhe mbushja me zhavor adekuat, ngjeshja dhe betonimi për vendosjen e anësoreve të reja	m ³	1.00	30.00	30.00 €
1.3	Furnizimi, transporti dhe riparimi i dyshemesë, ku përfshihen kubëzat e dëmtuara, largimi i tyre, furnizimi dhe mbushja me zhavor adekuat, ngjeshja dhe vendosja e kubëzave të reja.	m ²	1.00	32.00	32.00 €
1.4	Furnizimi dhe punimi pllakes nga betoni i armuar me trashësi 10cm me armaturë rrjetë Q-355 duke punuar dilatimet e nevojshme çdo 6m' për stazat e ecjes. Betonit ti shtohet aditivi për rezistencë ndaj lageshtisë. Ti kushtohet kujdes nivelimit dhe evitimit të gropave dhe deformimeve gjatë betonimit.	m ³	1.00	152.00	152.00 €
1.5	Furnizimi dhe montimi i dyshemesë nga goma fleksibile "B40 rubber" t= 40 mm 500 x500 mm 28 kg, e recikluar me qëndrueshmëri UV, shtresa e sipërme me granula me EPDM, sipas standarte të BE standarit (EN1177: 2008), TÜV qertifikata. Të gjitha shtresat e dyshemesë të jenë sistem i një prodhuesi duke përfshirë edhe ngjitetës atadekuat. Ky pozicion të realizohet medeemos nga stafi profesional i trajnuar për realizim të produktit dhe në tërësi sipas udhëzimeve të prodhuesit. Vërejtje: Pjerrtësia e terenit duhet të jetë 2-3%. Prodhuesi CSO Rubber Floorings ose prodhues i ngajshëm me te njëjtat karakteristika.	m ²	1.00	50.00	50.00 €
1.6	Furnizimi, transporti, riparimi dhe ngjyrosja e pjesve të drurit me ngjyr, ku perfshihen ngjyrosja rezistente per ambiente te jashtme.	m ²	1.00	5.00	5.00 €
1.7	Konstruktion i jasht meilik (me trashësi 5 mm-klassa I). Saldimi, Grryerja, ngjyrosja 3 ne 1 (bazë shtres e parë shtres e dytë) dhe shtangime e profileve sipas nevojës	m'	1.00	35.00	35.00 €

1.8	Sanimi i lodrave sipas nevojes si psh. Zinxhirët, llagerët (kushineta), ulsen, susta, sajle, litar etj.	copë	1.00	98.00	98.00 €	
1.9	Furnizimi, transporti, gryerja dhe ngjyrosja e konstruksioneve metalike me dy shtresa (me ngjyr kunder korruzionit).	m^2	1.00	4.50	4.50 €	
1.10	Furnizimi, transporti si dhe adaptimi i drrasave me dimensione sipas gjendjes në teren, duke përfshirë bulonat, gozhdat.	m^3	1.00	260.00	260.00 €	
Totali:					691.50 €	
2	Furnizim dhe montim: Lodrat, pajisjet e fitnesit, ulëset dhe shportat					
	<i>Lodrat në hapësirë të hapur. Pajiset të janë të prodhua fabrikisht nga prodhuesi I specializuar në këtë lloj të prodhimit me produkte të kualitetit të lartë me ateste të posaçme të shfrytëzimit të produktit , me funksionalizim, dizajn atraktiv dhe rezistencë të madhe ndaj vandalizmit dhe kushteve atmosferike. Të gjitha pajiset të janë të punuara sipas standardeve ISO 14001 dhe ISO 9001. Produkti të mos përmbarë kemikale të dëmshme. Çdo pajisje të përbajë udhëzimin e përdorimit dhe përshkrimin e funksioneve . Konstruksioni bazë i produkteve të jetë nga çeliku, të mbrojtura me ngjyrë ekologjike me sistem pudër ose zallim. Çmimi përfshin furnizimin, transportin dhe montimin në tërësi sipas udhëzimit të prodhuesit. Ofertuesi të prezantojë katalogje të prodhuesit të specializuar.</i>			2:Totali i (80 % e pikëve për vlerësim)		
2.1	Furnizimi me material si dhe montimi I luhatëseve përf fëmijë të vegjël 3-12 vjet (Steel swings) me 2 luhatse, luhatset të metalta dhe me drrasa të klasit të parë të ngjyrosura të lidhura me zingjir në llagerin e salduar në gyp metalik 90mm . Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional.		copë	1.00	740.00	740.00 €

2.2	Furnizimi me material si dhe montimi i lodrave përfshirë punimin e themelive nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. 	copë	1.00	510.00	510.00 €
2.3	Furnizimi me material si dhe montimi i lodrave përfshirë punimin e themelive nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. (përgjedhja të bëhet nga organi mbikëqyrës). 	copë	1.00	600.00	600.00 €
2.4	Furnizimi dhe montimi i paisja per ushtrimet e kembeve per dy persona duhet te jete me dizajn, funksionalitet dhe dimensione te percaktuara ne vizatimin teknik Profilet mbajtese duhet te jene nga gypat me diameter minimum 140 mm(5") me trashesi 3-4,5 mm dhe me gjatesi 150 cm. • Pjesët e lëvizshme të lidhura me trupin kryesor duhet te kenë diametrin te paktën 60 mm dhe trashesine e murit 3-4 mm Boshtet duhet te kene nga 2 kushineta me seri 6007 2 RS 	copë	1.00	580.00	580.00 €

2.5	<p>Furnizimi dhe montimi i paisja e ushtrimeve per dy persona duhet te jete me dizajn, funksionalitet dhe dimensione te percaktuara ne vizatimin teknik</p> <p>Pjesët e lëvizshme ne forme U të lidhura me shtyllen kryesore duhet tē kenë diametrin te paktën 60 mm dhe trashesine e murit 3-4 mm</p> <p>Boshtet e lëvizshme që sigurojnë lëvizjen duhet tē prodhohen me një sistem ndalues në mënyrë që tē parandalojnë lendimin e përdoruesit dhe tē zgjasin jetëgjatësinë e produktit. Krahët e lëvizshëm duhet tē mundesojne lëvizjen në një kënd maksimal prej 55°.</p> <p>Lidheset e pjesave te levizshme te ketije sistemi te ecjes duhet tē jenë prej gypave me diametër 2 "dhe 1000 mm tē gjatë dhe duhet tē jenë tē lakuar në mënyrë që tē sigurojnë tē paktën 40 cm ngshtim midis nivelit të belit dhe nivelit të këmbës.</p>		copë	1.00	560.00	560.00 €
2.6	<p>Furnizimi dhe montimi i paisja per ushtrimet e kembeve dhe belit per dy persona duhet te jete me dizajn, funksionalitet dhe dimensione te percaktuara ne vizatimin teknik</p> <p>Profilet mbajtese duhet te jene nga gypat me diameter minimum 140 mm(5") me trashesi 3-4,5 mm dhe me gjatesi 120 cm. Boshtet ne pjesen rrotulluese duhet te mundesojne rrotullimin maksimal deri ne 105 shkalle. Pjesët e lëvizshme të lidhura me shtyllen kryesore duhet tē kenë diametrin te paktën 60 mm dhe trashesine e murit 3-4 mm Në mënyrë që përdoruesi të kete mbështetje me duart e tij gjatë ushtrimeve, ne shtylle vendoset doreza ne forme te rrumbullaket</p>		copë	1.00	580.00	580.00 €

	Furnizimi dhe montimi i bicikletave statike per dy persona duhet te jete me dizajn, funksionalitet dhe dimensione te pecaktuara ne vizatimin teknik Profilet mbajtese duhet te jene nga gypat me diameter minimum 140 mm(5") me trashesi 3-4,5 mm dhe me gjatesi 120 cm. • Pjesët e lëvizshme të lidhura me trupin kryesor duhet të kenë diametrin te paktën 60 mm dhe trashesine e murit 3-4 mm • Pedalet duhet të prodhohen nga poliamidi i injektuar dhe te kene ngjyren originale Boshtet e pedaleve duhet te jene te qendrueshme ndaj ngarkeses dhe duhet te funksionojne pa zhurme, duhet te perdoren kushinetat me seri 6007 2 RS					
2.7		copë	1.00	520.00	520.00 €	
2.8	Furnizimi me material si dhe montimi i lodres Shtepija loder për fëmijë të vegjël (2-6) vjet e cila i ka dy ulese, një tavolin dhe shkronjat mbi tavolin. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet tē jetë funksional.		copë	1.00	1,395.00	1,395.00 €
2.9	Furnizimi me material si dhe montimi i lodres Alpinizëm për fëmijë (6-12) vjet, loda ne form trekendeshi per ngjitje (Climbing). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet tē jetë funksional.		copë	1.00	2,525.00	2,525.00 €

	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i lodres me kosh lekundës, me këto specifika: Lloji i produktit: Kosh lëkundes Seria: SWINGS SL-111</p> 				
2.10		copë	1.00	2,230.00	2,230.00 €
2.11	<p>Furnizimi me material si dhe montimi i lodres ngjitje ballancim për fëmijë (6-12) vjet, lodra per ngjitje (Balancing). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional.</p> 	copë	1.00	765.00	765.00 €
2.12	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i rrëshqitëses përfëmi, me këto specifika: Lloji i produktit: Rrëshqitje Seria: MOMENT Mosha: 2–6 vjet Vizitë manuale: 3 - 4 orë 2 persona Pesha: 110 kg Lartësia e lirë e vjeshtës: 1200 mm Zona e sigurisë: 23.5 m²</p> 	copë	1.00	2,740.00	2,740.00 €

2.13	<p>Furnizimi me material si dhe montimi i ulseve me gjatësi 2000mm dhe gjeresi 600mm, pozicioni përfshinë konstruksionin mbajtës (këmbët dhe mbështetësja) prej qeliku , ulset prej druri si dhe mbështetje prej druri. Në çmim duhet të parashihet ankerimi në dysheme si dhe lyerja me material për mbrojtje kundër lagështisë, insekteve, këpurdhave si dhe lyerje përfundimtare.</p> <p>Ulsja është për dy persona, punëkryesi obligohet që para vurjes në veper të marr aprovimin nga ana e organit mbikëqyrës si dhe gjithashtu paraprakisht të presentoj çertifikatat dhe atestet e nevojshme për aprovim nga ana e organit mbikëqyrës. Lloji i ulseve duhet të jet i patentuar dhe çertifikuar.</p> 		copë	1.00	380.00	380.00 €
2.14	<p>Furnizimi dhe montimi i shportës për mbeturina me dimensione 393*400 mm' dhe me lartësi 1005 mm' (100l). Shporta montohet me bulona. Ajo është e punuar nga struktura e fortë e pllakëzave metalike (6mm'). Dera është e punuar me shufra metalike (8 mm').</p> <p>Shporta ka një unazë çeliku për mbajtjes e qeseve plastike. E gjithë struktura është e zinkuar dhe e lyer me mveshje prej pluhur poliesteri. Të gjitha detalet janë dhënë në pjesën grafike të projektit.</p> <p>Modeli të jetë sipas fotos</p> 		copë	1.00	190.00	190.00 €
Totali:						14,315.00 €

REKAPITULLIM	Çmimi total	Çmimi total i peshuar
1 - Gjithsej 1 : 20%	€ 691.50	€ 138.30
2 - Gjithsej 2 : 35%	€ 14,315.00	€ 11,452.00
<i>Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen ne bazë të kësaj vlore). Kjo është vlera e cila do te duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.</i>		€ 11,590.30